

V E N D I M
Nr. 470, datë 31.8.2000

**PËR KALIMIN ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE, BANESAT DHE OBJEKTET E
KTHYERA NË BANESA, TË NDËRTUARA DHE TË BLERA ME FONDET E ISH-
SHOQËRISË “ALBPETROL”, SH.A.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimeve nr.198, datë 4.5.1993, “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” dhe nr.883, datë 16.12.1996, “Për disa kritere për përdorimin e fondeve buxhetore për ndërtimin dhe blerjen e banesave”, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Banesat e ndërtuara dhe të blera, deri në fund të vitit 1999, me fondet e ish-shoqërisë “Albpetrol”, sh.a., si dhe objektet ndërtimore, të shndërruara në objektet banimi, që sot janë pronë e shoqërive “Albpetrol”, sh.a., “Armo”, sh.a. dhe “Servecom”, sh.a. t’i kalojnë Entit Kombëtar të Banesave.

2. Vlera e banesave, të ndërtuara e të blera, si dhe vlera e objekteve të kthyera në banesa, sipas lidhjeve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me kalimin e tyre Entit Kombëtar të Banesave, të llogariten si shlyerje e detyrimeve të prapambetura, që i ka buxhetit të shtetit ish-shoqëria “Albpetrol”, sh.a.

3. Shoqëria “Albanian Petroleum Corporation”, sh.a, në Tiranë, shoqëritë “Albpetrol”, sh.a, “Armo”, sh.a. “Servocom”, sh.a, dhe Enti Kombëtar i Banesave, së bashku me degët e tij në rrethet përkatëse, të marrin masat përkatëse për realizimin e kalimin, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

4. Enti Kombëtar i Banesave dhe degët e tij në rrethet të realizojnë privatizimin e këtyre banesave, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta